dur shpirtërore, atë dashuri që i mbante të lidhur përjetësisht me Krijuesin nga njera anë dhe fatet e përgjakura të kombit nga ana tjetër. Por ne dhe gjithë brezat e tjerë u jemi po kaq mirënjohës për devocionin e tyre ndaj besimit dhe atdheut, myhibëve dhe dashamirësve të udhës sonë: Qamil Isuf Lamaj, Reshat Brahim Memushaj, Dino Xhemal Memlikaj, Selman Galip Memlikaj, Qani Myftar Kapllani, Qazim Kamber Kapllani, Selfo Haxhi Kapllani, Sulo Xhelo Kapllani, Muharrem Rushit Kapllani, Sheme Muhamet Xhemalaj, Shefit Barjam Xhemalaj, Mehmet Ismail Xhamalaj, Haxhi Jashar Xhemalaj, Bektash Halim Xhemalaj, Ismail Feta Malaj, Riza Hysen Malaj, Luto Lame Jaupaj. Nder dhe lavdi për këta dëshmorë të cilët përjetësisht prehen në këtë vend të bekuar!

Selia e Shenjtë Bektashiane e sheh sot këtë ceremonial modest, jo vetëm si një akt historik që vlen të kujtohet. Më tepër se kaq, ne jemi të ndërgjegjshëm se duhet të bëjmë më shumë sidomos në kontekst të zhvillimeve të sotëm. Ne vlen, më mirë se deri më sot, të hedhim dritë mbi këtë masakër fashiste të 75

viteve më parë, jo për t'u mburrur se çkanë bërë të parët tanë, po për t'i edukuar brezat e sotëm bektashianë në Tepelenë, Shqipëri dhe gjithë botën me vlerat e pallogaritshme kombëtare që kemi në vëllazërinë tonë. Sepse me këtë besim të kulluar do të jemi më pranë njeri-tjetrit, më pranë

Krijuesit më pranë të vërtetave të mëdha shpirtërore dhe njerëzore. Zoti e lartëssoftë krenarinë dhe respektin tonë për dëshmorët e Rabijes.”

Më tej ishte zv prefekti i Qarkut të Gjirokastrës z. Avni Lala, i cili pasi falenderoi organizatorët e këtij eventi, Selinë e Shenjtë

Bektashiane si edhe Bashkinë e Memaliajt, shtoi: “Përshendetje të gjithëve, në këtë 75 vjetor përkujtojmë atë masakër ku ngelën të vrarë 27 njerëz të pafajshëm në luftë me pushtuesit Italian mes tyre dhe baba Abazi nga ky fshat Rabie. Me qindra banorë të Buzit e të gjithë krahinës u rreshtuan në formacionet luftarake për të çliruar vendin nga pushtuesit e huaj. Veprimtaria e Abaz Rabijes ishte e gjithanshme dhe gjatë gjithë kohës por u fuqizua më shumë pas pushtimit të vendit nga pushtuesit Italian. Bashkimi i bektashinjve me frontin e rezistencës kundër pushtuesve, duke deklaruar se teqeja është në dispozicion të luftës dhe këtë e deklaroi para Mustafa Matohitit është më tepër se një vlerë historike. Njerëzit dhe mushkat e teqesë së Rabijes nuk pushuan së shërbyeri njerëzve të frontit të çlirimit. Pala italiane duke parë rezistencën e forcave të teqesë organizoi rrethimi në befasi të plotë natën duke u gdhirë 24 korriku 1943. Kjo natë ishte masakra e Rabijes. Dëshmitarë të vërtetë janë ata që i mbijetuan dhe shpëtuan kësaj masakre. Baba Abazit i kërkuan të tradhëtonte por ai nuk pranoi.

Në teqe një letër vjen,  
Baba ktheje fjalën –ë,  
Unë fjalën nuk e kthej,  
Jezit mbaro punën-e.

Fjala e tij e fundit para skuadrës së pushkatimit ishte: Populli i Tepelenës dhe unë jemi të gjithë partizan. Rroftë Shqipëria. Fashistët vranë fizikisht 27 burra por nuk vranë fjalën, nuk vranë lirinë, nuk vranë zemrat e buzjotëve pse fitoi liria dhe vendi u çlirua. Vlerësim për kurorëzimin, vlerësim për bashkëpunimin dhe kordinimin e

## Isha i vogël , s'mund ta kuptoja dervish Barjamin

I ka kaluar të 80-at dhe si nëpër ëndër kujton korrikun e vitit 1943.



edhe hajdaria. Ndërsa brenda syve, thellë, shumë thellë brenda tyre, im atë dalloj diçka, ndaj edhe iu lut që të rrinte në shtëpi atë natë. Jemi vëllezër, i tha im atë, na ka marrë malli. Rri sonte dhe nesër në saba të përcjellë unë për teqe.

Dervish Barjami e pa drejt në sy tim et dhe nuk foli. Unë i vajta pranë dhe me ato duart e tij të mëdha, po më përkëdhelte kokën. Pasi u mendua gjatë, tha nuk mund të rrinte dot atë mbrëmje, sepse nuk mund ta linte baba Abazin të vetëm përballë rreziqesh. Im atë sikur parandjente diçka dhe i tha: “Po mirë ik dhe hajde këto dy-tri ditë!” Unë i putha gjoksin ndërsa i hipte kalit. Ai nuk foli fare. Madje as kokën nuk e ktheu pas, sikur nuk donte t'ia shihnim sytë për të fundit herë.

Fetah Lamaj vijon: “Isha i vogël, s'mund të kuptoja xhaxhanë tim, dervish Barjamin. S'mund të kuptoja çfarë ishte dashuria e dervishit për babanë e teqesë. Kuptova vetëm diçka. Që dashuria shpirtërore, ndaj Zotit, ishte shumë herë më e fuqishme ndaj asaj për familjen biologjike. Kam punuar disa dekada si oficer kundërajror me sytë nga qielli. Por s'kam mundur ende sot të deshifroj kodet qiellorë të dashurisë bektashiane.”

E quajën Fetah Lamaj dhe është nipi i devish Barjam Lamajt nga fshati Levani i Tepelenës, i cili u sakrifkua në teqen e Rabijes. Vitet kanë bërë të vetën, por ai më thotë se pamjen e xhaxhait të tij, dervish Barjamit, e ka ruajtur gjithmonë brenda vehtes, siç mund të ruajmë gjërat e shtrenjta në këtë botë.

Për herë të fundit, e pashë xhaxhanë më 30 korrik 1943. Kishte qënë në teqen e Koshtanit. Kështu i tha tim eti dhe erdhi tek ne, vetëm për t'u shlodhur prej asaj vape të madhe. Rrobat i mbante kurdoherë të pastra. I ndrinin edhe harkaja

bektashizmit me forcat e çlirimit. I paharruar sakrificat dhe gjaku i tyre. Le të ngelen të pavdekshëm këto simbole të çlirimit dhe historia e tyre të trashëgohet në brezat që do vinë.” Ndërsa Kryetari i Bashkisë të Tepelenës, z. Tërmet Peçi, në përshëndetjen e tij solli ndër mendjet e të pranishmëve se luftëtarët e lirisë nuk i kanë munguar Tepelenës në asnjë moment kyç të historisë së kombit tonë. Me jetën trimërore të tyre dhe gjakun e falur, ata vaditën themelet e lirisë, duke e renditur Shqipërinë, edhe në ata vite të turbullt të Luftës së Dytë Botërore, në krahun e popujve që sakrifkuan për pavarësi dhe sovranitet. Veçmas, përfundoi ai, ngjarja e teqesë bektashiane në Rabije, na bënë bektashinje jo vetëm krenarë për tarikatën që i përkasim, por edhe të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë

historike që kemi përpara.

Emocione ngjalli tek të pranishmit edhe përshëndetja e veteranit Izet Kapllanaj, i fundmi dëshmitar i gjallë i masakrës së Rabijes. Ai falenderoi Selinë e Shenjtë Bektashiane, e cila përkujton ngjarje të tilla dhe me pjekurinë e sigurinë e moshës na këshilloi të gjithëve: “Mos harroni teqen e Rabijes. Italiani erdhi deri këtu lart, sepse nga kjo teqe i ishin prishur shumë plane, i ishin vrarë shumë ushtarë dhe këtë s’e pranote dot imperatoria romane. Por kur e drejta e Zotit është me ty, asgjë s’të ndal. Prandaj s’i ndali dot as frika, as dhimbja për jetët e tyre, këta dëshmorë që flenë sot këtu tek lisat. Prandaj edhe ju mos u ndalni për të vërtetën. Sot jemi në paqe, por Rabija do zbulohet, do mbajtur. Po harruat historinë do ju mbulojë harrimi.”

Ka vijuar paskëtaj Kryetari i

Bashkisë Memaliajt z. Durim Roshi, i cili është ndalur dhe ka vlerësuar masakrën e Rabijes, në kontekstin e ngjarjeve të kohës, ndërsa Dr. Shyqyri Hysi nga Universiteti “Çabej” në Gjirokastrë, solli për të pranishmit disa dokumenta arkivorë që hodhën dritë për pjesmarrjen e tepelenasve në luftrat 1939-1944 duke u ndalur në fund në vrasjen e martirëve bektashianë. Një përshëndetje e veçantë erdhi në këtë event edhe nga Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës, përmes z. Shkëlqim Guçe, i cili tha midis të tjerëve se lëvizja çlirimtare për liri dhe prosperitet gjeti tek teqet bektashiane të Jugut të Shqipërisë mbështetjen më të fuqishme dhe vetëm 24 korriku i vitit 1943 na kujton më shumë nga ç’duhet. Prandaj sot takohen në një pikë krenaria bektashiane dhe ngjallimi i veteranëve, të cilët edhe





sot përcjellin vetëm mesazhe dhimburie dhe paqeje. Ka qënë Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili në këto çaste të paharruara ka shpërndarë disa "Mirënjohje" për eventin në fjalë, ndërsa sekretarja e këshillit Bashkiak të Memaliajt znj. Liliana Sala ka bërë me dije të pranishmit se myhibët, dervishët dhe babai i teqesë së Rabijes, me vendim të atij këshilli janë shpallur "Nderi i Memaliajt."

Pastaj klerikët, përfaqësuesit e lartë të pushtetit vendor, familjarët e të rënëvet, me kurora e tufa të freskëta i drejtohen vendit të bekuar të dikurshëm, i cili sot shërben si vendprehje e dëshmorëve. Restaurimi i pllakave dhe i lapidarit, si edhe punimet përreth u mbaruan brenda disa ditëve nga Selia Bektashiane, në respekt të devocionit të atyre burrave që vunë në jetë porosinë e vyer të Haxhi Bektash Veliut, se kur atdheu të kërkon ndihmë vien t'ia japësh menjëherë. Ky akt natyrisht është farz për çdo besimtar bektashian, po aq sa edhe ndenja njerëzore e përcjellë në breza. Kryegjyshi Botëror propozon një minutë heshtje dhe vetëtimthi në memorien e të gjithëve, vrasja mizore e italianëve kalon si një shkrepëtimë dimri. Shoh lotë në sytë e klerikëve të sotëm. Për ata, dëshmorët, të djeshmit, paraardhësit. Shoh niper e mbesa të dervishëve dhe myhibëve bektashianë që

përkëdhelin në heshtje mermerin e vendprehjeve. Sërish mendja më vete në shkretëtirën e Qerbelasë, në ato dune rëre të përgjakura. Sigurisht emrat e komandatëve të lartë, ndjekësve të verbër të Jezidit, janë zhytur në pluhurin e harrimit. Ndërsa emrat e 72 dëshmorëve të Qerbelasë, të Imam Hysenit dhe Abaz Aliut, përmenden me dhimbje të thellë në mijëra vende, në kohra të ndryshme, nga miliona besimtarë të Islamit. Me po këtë respekt brezat shqiptarë do përcjellin dëshmorët e rënë në Rabije.

Një retrospektivë disi tronditëse na vjen në këtë ceremonial përkujtimor edhe përmes një fotoekspozite të realizuar me plot pasion nga grupi i punës Enver Kushi, Sotirulla Hoxha, Nuri Çuni. Në këtë ekspozitë është bërë e mundur përzgjedhja në memorien e teqeve të Tepelenës, ngjarjet më të spikatura, duke dashur të dëshmohet veç të tjerave një ndërthurje të jetëve shpirtërorë dhe fizike të teqeve me njëra tjetrën, në kontakt të misionit të tyre aq fisnik, gati të papërsëritshëm. Dhe më tej këngët labe. Ato që na shoqërojnë ngado si një bekim prej baballarëve tanë, të djeshëm dhe të sotëm.

**Syrja Xhelaj-Rabije  
korrik 2018.**



# Martaneshi një ëndër

Nga Moikom Zeqo

**K**am shkruar disa herë në vite për bektashizmin shqiptar, i fthillëzuar nga panteizmi i çuditshëm i shiitëve, që Trojën e tyre e quajnë Qerbela. Në shekullin XIX poeti demiurg Naim Frashëri, mori nismën e pabesueshme dot për të krijuar një mistikë familjare dhe shpirtërore për shqiptarët e tij, pra bektashizmin tipologjik dhe perbashkues gjitheshqiptar. Në këtë optikë Naim Frashëri ka ngjashmëri me racën e profetëve. Ai qe Poeti. Por Ai qe edhe Konstruktori i një religjioni sinkretik për shqiptarët e ndarë në disa fe, por kryesisht midis varianteve të krishterimit dhe të myslimanizmit, ose për një lidhje të besueshme dhe simbolike midis tyre.

Kjo qe kryeidea. Naim Frashëri e shkroi një traktat të Bektashizmit Shqiptar, si një përpjekje sinkronizuese dhe unitare. Ai shkroi poezi për Krishtin, si dhe përktheu pjesë nga Bibla, por dhe nga shkrimet e Imam Aliut. Ai mendonte për një doktrinë kombëtare fetare, ndonëse si një utopi stimuluese shpirtërore. Në këtë pikë Naimi e protestantizonte bektashizmin

dhe doktrinën mistike të shiitëve, ashtu si Martin Luteri reformoi dhe protestantizoi krishterimin.

Në librat e mi "Syri i Tretë, Naim Frashëri dhe bektashizmi" si dhe "Princërit e Mistikës" botuar gati 20 vjet më parë, e kam ravizuar, skicuar, theksuar karakterin novator, atdhetar të bektashizmit dhe Kryeprincit të Mistikës në letrat shqipe, Naimit të pavdekshëm.

Bektashizmi, që e ka Selinë e tij Botërore në Tiranë, përherë e ka iluminuar shqiptarinë e shekujve. Ky religjion sinkretik i jashtëzakonshëm, për fat të keq është ende pak i studiuar.

Jam shprehur se bektashizmi universal shqiptar duhet të jetë në mbrojtjen e UNESCO-s si trashëgimi dhe pasuri e patjetërsueshme e njerëzimit, ashtu si religjioni tjetër mistik i Tibetit.

Bektashizmi tek shqiptarët, ka edhe tri pelegrinazhe të mëdha. Pelegrinazhi i parë është ai i Sari Salltëkut në malin e Krujës. Pelegrinazhi i dytë, por më i madhi në Ballkan është ai i Tomorit, në Kulmak, tek Tyrbja e Abaz Aliut. Pelegrinazhi i tretë është ai i shpellës së Ballëm Sulltanit në Ballenjë të Martaneshit, që në 29 qershor festohet çdo ditë. Shumë ngjarje dhe të

vërteta historike i përkisnin kohërave të hershme, që kur Teqja e Martaneshit u hap si institucion nga martaneshasi Baba Hysen Mali (Rama) në Kullën e Pashës, tek Vendi i Shenjtë i Ballëm Sulltanit në Teqen e epërme me Ballenj, pikërisht ,aty, ku ndodhën dy ngjarje të mëdha kundra turqve, që përjetohet me këngën popullore „Zjarr në male e zjarr në bjeshkë“, apo me ngjarje përsëri të betejave me turqit, nga u nis baba Fejzo me baba Hysenin dhe luftëtarët e tyre drejt Xixullës të Martaneshit, ku ranë 12 dëshmorë në fushë të nderit. Këto histori ishin dhe janë të prekshme edhe sot. Një nga këto vlera është predikimi i vëllazërimit, ku të gjithë baballarët në breza e kishin dhe e kanë në qendër të vëmendjes baba Hysenin, që vërtet Teqen e ngriti në Martanesh, por trupi i tij sipas amanetit të tij u varros në Zerqan të Dibrës. Kështu mund të themi, se gjysma e tokave të Martaneshit ishte futur nën ujë, falë organizimit të baballarëve bektashianë të zones, për zgjidhjen e problemit të pronësisë, të teknikës dhe krahut të punës, që në kohën e baba Hysenit për vijën e malit për fshatin

Lenë dhe vijën e Zallit në kohën e baba Jasharit të fshatit Peshk etj. Në atë kohë Teqja ngriti një gatër me ujë në Kaptinë të Martaneshit për nxjerrjen e dërrasave apo mulli bloje, si dhe Valanica për rrobat e leshta.

Më pas u ndërtua një hidrocentral elektrik nga Baba Selimi, i cili krahas teqes siguronte energji elektrike edhe për një pjesë të fshatit. Një punë të lavdërueshme baballarët bektashianë bënë edhe në fushën e arsimit, ku spikati puna e palodhur e Baba Jasharit, që arriti të hapë Shkollën Shqipe në Martanesh në vitin 1908, por që për hir të së vërtetës shkolla të tilla ,nuk gjendeshin në atë kohë,, në Tiranë, Durrës, Shkodër apo gjetkë. Edhe në fushën e kulturës u punua në krahinën e Martaneshit sidomos në kohën e Baba Selimit, i cili në Teqe kishte siguruar piano e fizarmonikë, gjë që tërhoqi vëmendjen e Pushtetit Qendror komunist, i cili deklaronte, se Babai i Martaneshit ka thithur rininë dhe ka bërë një hidrocentral elektrik dhe një dhomë kulture.

Thënia bektashianë se ” Pa atdhe nuk ka fe” gjeti manifestimin e

nevojshëm dhe jetik në tërë krahinën. Kështu, në teqen e epërme në kohën e Baba Jasharit në vitin 1878 erdhi si mysafir për punët e Shqipërisë dhe hallet e popullit atdhetari i njohur Abdyl Frashëri. Banorët vendas, sapo e panë këtë njeri madheshtor, zemerhekur, me mjekër, e kishin pritur me nderim si dhe temenara si një baba Bektashian. Baba Hajdari dy herë ka mbledhur me armë burrat e trimat e Martaneshit dhe kanë shkuar për të mbrojtur Shkodrën nga serbomalazezët, duke lënë gjak në beteja dhe gjurmë në historinë e lavdishme të kësaj zone. Nën influencën e Aqif Pashë Elbasanit, që e kish mik, baba Jasharit në Teqen e Martaneshit më 25 nëntor 1912 ngriti Flamurin Kombëtar të Pavarësisë, pra, fill mbas Elbasanit. Po në këtë Teqe u mbledh populli për të përballuar ”kryengritjen” e Haxhi Qamilit, ose siç i thonin në Martanesh Haxhi Fushës.

Në Ballenj, Baba Selimi, punëtor i madh, ka bërë ndërtimin e dy teqeve, në gur dhe arkitekturë tërheqëse. Pikërisht në sheshin, e pyllit të Ballenjës bëhet edhe pelegrinazhi i madh i 29 qershorit



çdo vit. E veçanta e krahinës së Martaneshit janë edhe bujaria, toleranca dhe urtësia.

Është e vetmja krahinë, apo një nga të paktat krahina, që nuk ka asnjë vëllavrasje dhe nuk njihet ngujimi kanunor. Kur kujtojmë këto, natyrshëm gëzohemi dhe krenohemi aq sa paradoksale tingëllon puna e drejtuesve të pushtetit, ku për fat të keq edhe e disa intelektualëve vendorë, kur ju dha mundësia të shërbenin në vendin e tyre, në vend që të paktën të ruanin dhe të administronin çfarë gjetën, bënë të kundërtën. Mjafton të përmendim Qytetin e Krastës, dikur i lakmuar, i famshëm dhe sot është i tkurrur mjerisht dhe pa kuptim, me ca pallate gërmadhë, gati prej fantazme. Apo siç janë në dijeni të gjithë si janë katandisur minierat e famshme dhe me emer boteror te kromit, apo shkatërrimi i mijëra hektarëve pyje të jashtëzakonshëm. Ndarja administrative e Martaneshit, mua, më duket absurde. Për vetë kushtet natyrore, 90 përqind e Martaneshit është malësi e e paskrahëve të Tiranës. Pse të mos lidhej administrativisht me Tiranën?

Një konceptim i tillë do të që tepër zhvillimor dhe progresiv. Kjo do të përforconte motivimin ekonomik të Martaneshit dhe do të krijonte mundësitë për një shndërrim të Martaneshit për Tiranën, në një parajsë turistike ekologjike.

Po si lindi ideja e pelegrinazhit popullor të kultit bektashian më 29 qershor?

Unë jam dëshmitar i kësaj nisme. Duke qenë mik me Kryegjyshin Botëror, Baba Dede Reshat Bardhin, me Baba Mondin, sot Kryegjysh Botëror, por edhe dentistin dhe intelektualin e shquar martaneshas Agim Biçakun, tepër i përkushtuar për bektashizmin dhe krahinën e tij, me Baba Selimin shembullor të Ballenjës dhe krejt Martaneshit, e di se në 22 maj 2003 u vendos që të organizohej ky Pelegrinazh në datën 29 qershor. I përvitshëm! Që në vitin e parë, para 15 vitesh Pelegrinazhi u bë krejt popullor. Në të kam qenë shpesh edhe unë, por kanë ardhur edhe Pëllumb Xhufi, Xhevahir Spahiu, deputetë etj, por edhe shume artistë nga e gjithë Shqipëria, madje edhe Cirku Kombëtar i Tiranës. 29 qershori është

një festë gjithëpërfshirëse. Më ka rënë rasti të flas në disa kanale televizive, të Francës, Turqisë, Gjermanisë madje edhe të Spanjës, si dhe të Bilbaos së baskëve, që kanë ardhur në 29 qershor në Ballënjë, të interesuar për pelegrinazhin por edhe e mistiken bektashiane të shqiptareve! Edhe ky aspekt i interesimit ndërkombëtar i jep një ndjeshmëri dhe kuptimshmëri këtij pelegrinazhi. Pelegrinazhi përqendrohet tek shpella, e quajtur e Ballem Sulltanit, Pirit të Dytë të Bektashizmit, ose siç njihet Guva Mistike. Natyra përrallore e mjedisit, plot burime ujërash dhe pisha dhe ahe vigane, përbën një skenë gati fantazmagorike.

Kryegjyshi Botëror, Baba Mondin, i ka dhënë një rëndësi të posaçme këtij Pelegrinazhi. Ky shkrim im është gjithashtu një grishje e zemrës dhe e mendjes, e shpirtit dhe e dashurisë njerëzore. Martaneshi është një ëndërr e artë. Gjeografia ka krijuar diçka sublime dhe të papërsëritshme. Por kjo zonë duhet administruar. Me vizion të denjë për një të ardhme.



**A**ty në teqenë e lëndinës bektashiane të Kiçokut, në ditën e bekuar të pelegrinazhit të këtij viti, je i rrethuar nga dy bukuri njëherësh. E para është bukuria e shpirtit, e këtyre njerëzve që kanë ardhur në respekt të bektashizmit. E sheh sidomos në merakun e vëllezërve Cenollari, për të pritur miqtë, për t'i respektuar ata, për t'u rrëfyer çfarë kujtojnë prej kësaj teqeje, dikur aq të famshme. Ndërsa bukuria tjetër lidhet padyshim, me gjeografinë. Prej bregut të teqesë duket maja e Gllavës, më tej Nemërçka ndërsa përballë, hijerëndë, mali i Tomorrit. Të parët tanë, baballarët bektashinj, u kujdesën që

lartësitë e maleve të jetonin në harmoninë më të mrekulueshme me thellësitë e shpirttrave. Dhe jo thjeshtë për hir të besimit. Por në mënyrë të veçantë për mbarësinë dhe ardhmërinë e kombit tonë.

Sipas toponomisë së shekujve të shkuar, vendi i sotëm i teqesë është quajtur Derbend. Deri këtu është ngjitur në vitet 1887-1888, baba Kamber Sadikaj nga fshati Leskovec i Dëshnicës. Kishte nisur të zgjohej vetëdija jonë kombëtare dhe brenda këtij zgjimi, klerikët bektashianë parashihnin veprimtarinë e tyre fetare të pandarë nga fjala, librat, shkolla dhe përpjekjet shqiptare.

# Një lavdi që pret të zgjohet



Tyrbe e Kiçokut - Përmet. Foto e vitit 1921.

**BABA KAMBER SADIKAJ:** "Nëse pas urdhrit të Zotit të Madh, shkoj nga kjo jetë, gjithçka nga dergjahu derbend, afër Bubësit, me tapitë dhe letrat oficiale, tokat dhe pyjet që kufizojnë dergjahun në kaza të Përmetit, mulliri afër fshatit Mariçaj në Kaza të Tepelenës, si dhe tokat e pyjet po i dhuroj dhe i bëj vakëf, që të mund të çelet prap ky dergjah nën komandë të një babai a dedei nga Udhë e Hakut, të shërbejë për lutjet e tarikatit dhe për të shtuarët e djemve të udhës bektashiane... Por meqenëse dëshira ime është ndriçimi dhe naltësimi i djemëve të mëmëdheut, lutem për ndenjësit e dergjahut që të çelet në teqenë e Derbendit një shkollë fillore, ose e natës, ose të paktën të mbahen nja dy mësonjës të shqipes për t'u dhënë mësim dervishëve, myhibëve apo djemve të tyre..."

Për tridhjetë vjet me radhë, babai që pati bërë mrekullinë deri në Pirevinë e largët, premtoi se do të vijonte me mrekullitë e tij dhe në lartësitë e këtyre maleve ku dikur kishte pasur vetëm shqiponja dhe pëllumba të egër. Vështirë të mendohet sot se si u ndrit ajo teqe në vitet 1890-1895, por gurët që kanë mbetur si dëshmi e vetme e asaj kohe rrëfejnë për një skalitje e punim të rrallë, njësh me ata të shtëpive beratase të ndërtuara në vitet 1700.

Baba Kamberi i ndoqi me shqetësim ngjarjet e viteve 1913-1914, atëherë kur andartët grekë iu vërsulën teqeve bektashiane me një egërsi të pa imagjinueshme, duke i djegur nga themelet. I përkrahur prej disa myhibëve dhe dervishëve të tij, ai u largua plot dhimbje nga Derbendi dhe duke qenë i shtyrë në moshë la edhe këtë testament të shkruar dhe depozituar sipas ligjeve të kohës. Midis të tjerave aty thuhet: "Nëse pas urdhrit të Zotit të Madh, shkoj nga kjo jetë, gjithçka nga dergjahu derbend, afër Bubësit, me tapitë dhe letrat oficiale, tokat dhe pyjet që kufizojnë dergjahun në kaza të Përmetit, mulliri afër fshatit Mariçaj në Kaza të Tepelenës, si dhe tokat e pyjet po i dhuroj dhe i bëj vakëf, që të mund të çelet prap ky dergjah nën komandë të një babai a dedei nga Udhë e Hakut, të shërbejë për lutjet e tarikatit dhe për të shtuarët e djemve të udhës bektashiane... Por meqenëse dëshira ime është ndriçimi dhe naltësimi i djemëve të mëmëdheut, lutem për ndenjësit e dergjahut që të çelet në teqenë e Derbendit një shkollë fillore, ose e natës, ose të paktën të mbahen nja dy

mësonjës të shqipes për t'u dhënë mësim dervishëve, myhibëve apo djemve të tyre..."

Tyrbja e rindërtuar, me ata mezarë të mbajtur plot merak, në atë vend të bukur mbledh pelegrinë nga fshatrat e Përmetit, por edhe ata të Gjirokastrës dhe Tepelenës. Në bashkëbisedimin e tyre me mezarët, më duket se këta pelegrinë i rikthehen jetës më të vëmend-



shëm, sidomos ndaj bukurive shqiptare që ajo shpalos. Ndoshta, duke pasur para sysh një afrim të tillë të besimtarëve ndaj Zotit, Gazaliu i famshëm shkroi shekuj më parë se shumë prej këtyre njerëzve e kanë kuptuar se qiejt janë një shumësi. Ai që ve në lëvizje secilin prej qiejve të ndryshëm, është një qenie tjetër, e cila ka thirrur një engjëll dhe këta engjëj formojnë shumësinë e tyre. Lidhja e tyre me dritat hyjnore është si lidhja e yjeve me të gjitha dritat e tjera. Është vetë Zoti që u jep lëvizjen këtyre qiejve të largët.

Më bën përshtypje edhe një fakt shumë kuptimplotë.

Në tavolinën e madhe familjare që kanë shtruar vëllezërit Cenollari, vijnë të ftuar edhe nipër të baba Sejdin Kiçokut, i cili ka shërbyer në këtë teqe, deri në vitin e mbrapshtë 1967. Ata sjellin në bisedë merakun e thellë me të cilin baba Sejdini mbylli sytë në Dukaj të Tepelenës, me vështrimin e tretur kurdoherë në atë vend të bekuar, në teqenë e Kiçokut. Teqeja, gjithsesi, mbetet një lavdi që pret të zgjohet.

Xhelo Cenollari, nuk i shterin

askurrë kujtimet për të atin, Aliun, i cili u kujdes nga viti 1991 deri sa ndërroi jetë më 2012, për teqenë e Kiçokut. E rrethoi vendin, nisi të kujdeset për pemët frutore, çoi atje dritën, madje dhe ujin. Kujdesaj nga agu i mëngjesit, deri në mbrëmje. Sa herë shkonte në Tiranë, drejt e në teqe tek Reshat Bardhi. I tregonte fotografi nga teqeja dhe dedei e uronte dhe e bekonte.

Më 20 maj 2002, me porosi të dede Reshatit, teqeja u riçel dhe u krye i pari pelegrinazh, pas 35 vitesh. Xhelua më thotë se nuk e kishte parë të atin, Aliun, aq të lumtur. Mu bë zemra sa mali i Tomorrit, i kishte thënë dede Reshatit, ndërsa ky i qe përgjigjur me zërin e butë dhe vështrimin e kthjellët:

**Dritë do ta bëj Abaz Aliu këtu dhe deri në vatrat e tua në Tiranë, sepse Zoti i do ata njerëz që kujdesen për tyrbet dhe teqetë njëlloj siç kujdesen për shtëpitë e tyre.**

*Syrja Xhelaj,  
Kiçok, korrik 2018*



# Tek tyrb

**Q**indra besimtarë udhëtuan mëngjesin e 18 gushtit të këtij viti drejt Luftinjës në ditën e pelegrinazhit, duke sfiduar baltën e dherat e pakalueshëm në aksin rrugor që lidh rrugën nacionale me vendin e shenjtë bektashian që ndodhet në këtë fshat. Në këtë rrugëtim të vështirë por plot shpresa, kishte dhjetëra besimtarë që vinin dhe nga treva të tjera të vendit, Gjirokastra, Mallakastra, Përmeti, Skrapari, Lushnja etj...

Ishte baba Faiku që në ceremoninë përkatëse që nisi në orën 11:00 të kësaj dite, i cili përshëndeti të pranishmit duke iu uruar shëndet, begati e përkushtim në udhën e Ehli-Bejtit.

Më pas, u lexua përshëndetja e Kryegjyshit Botëror Bektashian, në të cilën ndër të tjera thuhet: "Të nderuar besimtarë bektashianë të Luftinjës, Izvorit, Zhapokikës dhe të tjerë të ardhur nga Mallakastra, Lazarati, Tepelena e fshatra të tjera të kësaj treve, të njohura për traditat historike të mbështetjes së besimit bektashian dhe atdhetarizmit! Jam i lumtur që sot në këtë eveniment, tu përshëndes

# ija e baba Isuf Horasanit

në emër të Kryegjyshit Botëror Bektashian dhe tu uroj më shumë dashuri, begati e mirësi në zemrat dhe familjet tuaja! Zoti i Lartë dhe Ehli-Bejti ynë i mrekullueshëm ju plotësoftë çdo dëshirë! Kjo tyrbe e mrekullueshme e baba Isuf Harasanit, e këtij misionari të madh, i cili përshkoi mijëra kilometra, në gati tre vjet, për të ardhur deri në këtë vend është padyshim një bekim jo vetëm për popullin e Luftinjës, por krejt Tepelenës. Në ato kohëra të vështira për krejt shqiptarët, mekami i bekuar i baba Isufit, plotësonte më së miri mozaikun bektashian në këto treva. Në bashkëveprim me teqenë historike të Gllavës dhe Turanit, në lidhje të thella me teqenë e Memaliajt dhe Krahësit, ky vend i shenjtë do të vinte në ndihmë të mijëra besimtarëve, duke iu kujtuar

atyre se besimi në Zotin e Lartë jo vetëm që nuk shuhet asnjëherë, por përkundrazi ai jeton në shpirtat e mrekullueshëm të atyre që besojnë. Besimtarët e kësaj treve, që sot kanë mbushur e mrekulluar këtë shesh, shpresoj që vitin që vjen në pelegrinazhin e radhës e në vazhdim, do të shtojnë pjesëmarrësit në këtë ditë të shënuar këtu, pasi besimi jonë 8000 vjeçar bektashian, është besimi që predikon më shumë mirësi, dashuri e respekt për vëllanë apo motrën që kemi në krah, pavarësisht bindjeve, moshës, ngjyrës apo etnisë”.

Bisedat e shumta mes besimtarëve dhe ato me klerikët e pranishëm në këtë event, vazhduar gjatë dhe në drekën e këndshme që pasoi këtë aktivitet të rëndësishëm tradicional.

**Koresp. 'Urtësia'.**

# Mesazh paqeje nga Shkëlzeni

Nuri Çuni

Udhëtimi tërheqës për në malin e Shkëlzenit këtë vit ishte i veçantë. Biseda e ngrohtë me dervish Sali Petin, z. Lirim Neziraj, punonjës në Komitetin Shtetëror të Kulteve, kurse dervishi, me njohuritë e tij për bektashizmin e bëri këtë udhëtim më të lehtë. Udhëtim i gjatë, Tiranë – Kukës-Krumë-Tropojë kaloi këndshëm dhe z. Lirim, që është nga Tropoja tregoi se pelegrinazhi në këtë vend ka filluar herët, aty vinin jo vetëm nga Tropoja dhe Kukësi, por edhe nga Kosova, Maqedonia e vende të tjera. Pelegrinët me përkushtim e gdhinin një natë jashtë, të nesërmen bënin ritualin dhe ktheheshin me gëzim e plotë shpresë, në shtëpitë e tyre. Pjesëmarrja në këtë rast solli jo vetëm gëzim por dha emocione

të thella shpirtërore në përkujtim të misionarit të parë ardhur në Ballkan dhe Shqipëri, Sarisalltik, në shekullin XIII.

Rruga gjarpëruese dhe e thiktë, në dritë dhe mjergull, në freskin e malit, të jep një ndijesi të thellë shpirtëror dhe hyn në magjinë e këtij mali të shenjtë. Sapo del në qafë me një sheshë të bukur dhe drejt majës së malit Shkëlzen në lindje, pelegrinët e mëngjezit dhe të mbrëmjes ktheheshin dhe vinin, dukej një harmoni, mali dhe njeriu. Ashtu papritur na takon Besfort Tafa, kryetari i “Shoqatës Shkëlzeni dhe Dritat e Tij”, i cili me shokët e tij përgatisnin vendin e ceremonialit për këtë ditë të shenjtë. Me gëzim na priti dhe na uroi mirëseardhjen me dashamirësi na tregoi edhe rrugën për të vazhduar në vendin e Shenjtë, Sarisalltik ku duhej të bënin rreth një orë më këmbë. Ashtu me gëzimin që kishim, dervish Sali Peti

filloi të ngjitej malit dhe në rrugën këmbësore gjarpëruese zbatuar në çorape, duke u takuar me pelegrinët që ktheheshin, ata na uronin, “u bekoftë vendi i mirë”, “paçi bekim” dhe përgjigjja ishte e njëjtë, në këtë ecje të lodhshme, por me gëzim arritëm në atë majë të veçantë, te varri i Sarisalltikut, i cili ishte rrethuar me gurë të thjeshtë rrethorë. Pranë varrit tij, ishin pelegrinët duke bërë ritualin fetar, burra, gra e fëmijë dhe të moshuar, i jepnin këtij vendi një ndijesi të veçantë. Ajo buronte nga vetë zemra e çdo pelegrini. Në lutjet e dervishit dhe besimtarve e rrethuan Vendin e Mirë, e në një lutje të përbashkët rreth këtij vendi, në menditim. Ku aty, sejcili kishte një ndjenjë të thellë shpirtërore dhe në qetësinë e plotë, si një mrekulli, që buronte nga ky vend dhe lehtësohej shpirtërisht, në meditim e rrallë, që mund ta bësh në këtë vend magjik.

Profeti Muhamed në hadithet e tij thotë: “Kur kini nevojë drejtohuni vendeve të shenjta”. Ashtu me shpirt në këtë ritual kthehemi përsëri në rrugën këmbësore, ulje e ngjitje, monopate dhe dukeshin më shumë male që e rrethonin, e pllaja pafund, me kullota fantastike alpine, kullosinin kope të tëra me dhënë, e stanet njëri pas tjetrit, kishin bukurinë e tyre.

Aty ndërkaq u takuam me klerikët e Tropojës dhe nga Kosova: dervish Muharrem Tafa, i moshuar, Sheh Idriz Osmani, Sheh Zade Gëzim Osmani nga Kosova, me Prefektin e Qarkut të Kuksit z. Zenel Kuçana, Kryetarin e Bashkisë Tropojë Besnik Dushaj. U hap ceremonia duke përhëndetur, Kryetari Bashkisë Tropojë, i cili uroi pelegrinët që: ... ”kjo ditë tashmë traditë në malin e Shkëlzenit do mbetet ditë shprese dhe gëzimi për të gjithë ne, duke mbajtur gjallë traditën





tonë të besimit dhe atdhetarizmit, ne shohim këtu gjithë këta të rinj dhe të reja me besim dhe shpresë për një të ardhme më të mirë, urojmë mbarësi në familjet tuaja!” Më pas Prefekti i Qarkut të Kuksit z. Zenel Kuçana theksoi se edhe në të ardhmen do ta festojmë më mire këtë ditë të veçant për gjithë Tropojën e Kuksin, duke krijuar kushte më të mira për rrugën e vështirë, e çuarja e saj deri te “Vendi i Mirë”. Shpreh kënaqësinë, gëzim e dashuri, për të gjithë ju, që kini ardhur me sakrificë e përkushtim, për t’ju falur këtij Vendi, i cili është për të gjithë ne shpresë”. Me këtë rast u shpërndan tituj nderi, midis të tjerave i dorëzohet titulli “Qytetar Nderi” nga Bashkia e Tropojës, dervish Muharrem Tafa. Në emër të Kryegjyshit Botërore Bektashianë dha mesazhin e Kryegjyshit dervish Sali Peti. ... “Është kënaqësinë e veçantë për mua, të marr pjesë në përkujtimin e kësaj dite të shenjtë, Vendi i Mirë, Sarisalltik. Si vazhdim i pelegrinazhit tradicional të përvitshëm në vendin e bekuar të Sari-Salltikut, si edhe të tyrbeve e teqeve të tjera në këtë trevë, në Shqipëri dhe Kosovë. Përkujtimi në këtë ditë të shenjtë të madh Sarisalltik mer një rëndësi për islamit dhe tarikatin bektashian në Shqipëri dhe në botë. Zoti i Lartë qoftë i kënaqur me devocionin tuaj dhe veprës së Ehli-Bejtit dhe u plotësoftë çdo dëshirë! Burimet historike tregojnë se Sari Salltiku ishte dërguar në Ballkan me porosi të vetë Haxhi Bektash Veliut. Historia e teqeve ka nisur në Shqipëri shumë herët, fillimisht në Krujë, në malin e Krujës, Shkëlzen, Mali Pashtrik, Mamuras, Laç, Shijak, e deri në Sarandë. Gjithashtu, në Pejë të Kosovës, Prizren, Ohër të Maqedonisë, Greqi në Korfuz e Çamëri dhe Bosnjë Hercegovinë.

Haxhi Bektash Veliu në Vilajet Nameja dhe Evliah Çelebiu në Sejahatname e kanë prezantuar Sari Salltikun në shek. XIII. të rëndësishëm, të vlefshëm, dijetar, evlija që ka patur edhe qeramete, duke i dhënë vlera të veçanta si person me virtyte të larta, që ka ushqyer veç dashuri. Relievi i shteteve ku ka vepruar është në një hapsirë të gjërë; në Azi, Evropë dhe Afrikë, por epiqendra e veprimtimit të

tij padyshim ka qenë Anadulli dhe Ballkani. Shumë autor të njohur si: Franc Babinger, Muzafer Tufan, eruditi i njohur Ekrem bej Vlora e të tjerë, bëjnë të njohur bibliografinë e e Sarisalltikut, midis doktrinës së besimit tonë të kulluar 800 vjeçar dhe disa porosive të Sari Salltikut ardhur përmes tregimeve dhe këngëve, legendave deri në ditët tona.

Historia flet për tyrben e Shkëlzenit, dervishi ynë ka shfaqur mrekullitë e veta. Fakti që ky vend i shenjtë respektohet nga gjithë, nga Tropoja dhe Kosova dhe krahinat e tjera, e ka bërë këtë pelegrinazh të madhërueshëm, dhe të ndenjë në forcën e shpirtit të lartë, për nder, komb, atdhe, që karakterizon gjithë Tropojën. Kjo krahinë në shekuj ka trashëguar këto virtyte të larta të paqes dashurisë vëllazërimit dhe atdhetarizmit që e dëshmojnë të gjithë personalitet kombëtarë, në harmoninë dhe tolerancën fetare. Dede Reshat Bardhi, ish Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve për këtë është shprehur: “Toleranca fetare në vendin tonë është një mrekulli. Fakti është, se të katër komunitetet tradicional në vendin tonë jetojnë në harmoni të plotë. Kjo përbën një shembull unikal, jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjërë. Ajo që i dallon shqiptarët nga të tjerët është se dashurinë e tyre të sinqertë në Zot, në shekuj ta shohim brenda dashurisë për fatet e kombit. Gjej rastin sot, të

falenderoj nga zemra dhe t’ju uroj jetë të gjatë drejtuesve të shoqatës Shkëlzeni me kryetar z. Besfort Tafa, klerikun e nderuar Muharrem Tafa, Sheh Idriz Osmani, Sheh Zade Gëzim Osmani, pushtetin vendor, Prefektin z. Zenel Kuçana, Kryetarin e Bashkisë z. Besnik Dushaj. që kanë vite, në organizimin e pelegrinazhit madhështor në malin e Shkëlzenit. Bëfshi gjithmonë punë dhe veprave të mira. Zoti i Lartë ju ndihmoftë në misionin tuaj fisnik!

Edhe njëherë miq të mij ju faleminderit që jini mbledhur sot këtu dhe paçi begati në familjet tuaja.”

Më pas u dha një koncert i mrekullueshëm artistik, i cili gjallëroi atmosferën e festës, me këngëtar nga Tropoja si: Marlen Qefalia, Agron Hoxha dhe këngëtar nga Kosova dhe diaspora, ansambli “Dardania”, koloriti i veshjeve tradicionale shkëlqeu në këtë ditë të bukur gushti. Në mbyllje kryetari i shoqatës “Shkëlzeni dhe Dritat e Tij”, z. Besfort Tafa falenderoi gjithë pjesëmarrsit, për praninë e klerikëve dhe të pushtetit vendor, kjo ditë e veçantë tashmë traditë do vazhdoj dhe urimet më të mira në familjen e sejcilit dhe urata e vendit të Shenjtë. I ftoi të pranishmit për drekën e përgatitur enkas për të gjithë. Urimet e bisedat e ngrohta vazhduan në këtë drekë dhe pelegrinët me besimtarët e shumë muarën atë ndjesi shpirtërore, që e japin vendet e mira, në pelegrinazhe të tilla.



# Fryma që na bashkon të gjithëve

**D**ita e 14 gushtit të këtij viti, ishte ditë e veçantë për banorët e Salarisë në Tepelenë e më gjerë, pasi për të dytin vit radhas, ata mblidhen në Qafën e Kreshtës, tek objekti i shenjtë për ritet tradicionale të pelegrinazhit bektashian. Edhe pse një pjesë e rrugës, ajo nga Bënça në Qafë të Kreshtës është tejet e amortizuar dhe pothuaj e pamundur për automjetet e vogla, kjo nuk i ka penguar karvanët e automjeteve e këmbësorëve që të nisin rrugëtimin që në orët e para të kësaj dite. Mes tyre, në rrugën e vështirë e plot kthesa, në ndalesat e detyruara për këtë shkak, takojmë besimtarë të shumtë. Ka mes tyre nga Tepelena, Mallakstra, nga Lazarati, Luftinja, Lushnja, nga treva të tjera të vendit e deri emigrantë që kanë ardhur në këtë periudhë me pushime në vendlindjen. Mes tyre është dhe 76-vjeçari N. Demo, me banim në Memaliaj. “Jam i lumtur që ja arritëm kësaj dite. Plot një vit më parë inauguruam tyrben në Qafën e Kreshtës, këtë vend të shenjtë që na afron për ditë e më shumë me rrugën e Haxhi Bektash Veliut, me dashurinë dhe adhurimin në të madhin Zot. Mblidhem i këtu e lehtësojmë shpirtrat, kërkojmë bekime shpresë për jetën” - pohon ai për revistën “Urtësia”...

Aktivitetin e çeli Dr. Sefer Shëhu, përfaqësues i komunitetit të Salarisë, i cili, ndër të tjera theksoi: “Përshëndetje nga zemra bashkëfshatarë të mijë të dashur.. Në emrin tuaj, kam nderin të përshëndes e falënderoj për pjesëmarrjen klerikët e pranishëm këtu, përfaqësuesin e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, dervish Mikelin dhe të gjithë besimtarët bektashinj të kësaj zone dhe të tjerë nga treva të tjera të vendit që kanë

ardhur sot në këtë ditë të shënuar në këtë vend të shenjtë, në Qafën e Kreshtës. Përshëndes gjithashtu nga zemra, bashkëfshatarin tonë Eqerem Braçe, për sipërmarrjen e mundimshme, por të lavdërueshme, ndërtimin e tyrbes. Ishte një dëshirë e përpjekje e hershme, të paktën që nga viti 2001, kur ne, një grup përfaqësuesish të komunitetit salarjot, u mblodhëm e prezantuam projektin e ndërtimit të një objekti bektashian në këtë vend, ku historia ka lënë gjurmë vitaliteti të komunitetit si besimtarë bektashian e atdhetarë... Dhe ja arritëm qëllimit. Vjet, këtu ne përuruar se bashku këtë objekt të shenjtë të besimit bektashian. Ndërsa sot, pas një viti, krenohemi se ka më shumë besimtarë që vijnë këtu, luten, bise-dojnë me njeri-tjetrin, marrin bekimin e klerikëve dhe shtojnë besimin dhe dashurinë për Krijuesin. Ju përgëzoj të gjithëve”.

Në vazhdim, përfaqësuesi i Kryegjyshit Botëror Bektashian, u përcolli të pranishmëve përshëndetjen e Hirësisë së Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ku ndër të tjera tha: “Plot një vit më parë, ne u mblodhëm në këtë vend dhe përuruar se bashku tyrben, duke përmbushur një dëshirë të besimtarëve bektashianë të kësaj treve, të cilët edhe në kohët më të vështira, kur besimi fetar u ndalua me ligj e institucionet fetar u shkatërruan, mbajtën gjallë në zemrat e tyre dashurinë për udhën e Ehli-Bejtit dhe në ato kushte të vështira, përpiqeshin e kryenin në mënyrë të fshehtë ritet e besimit bektashian. Është rasti, që për ngritjen e këtij objekti të shenjtë, të falënderojmë besimtarin dashamirës Eqerem Braçe e familjen e tij, klerikun e përkushtuar Dervish Mikel Onjeja, drejtuesit lokal, kontributorët e tjerë dhe besimtarët. Me fillesat e

veta në shekullin e 16-të, ky vend i mirë, falë pozicionit gjeografik do të shndërrohej në vendtakime të karvanëve të shumtë që lidhnin Konicën, Përmetin, Gjirokastrën, Janinën me viset e Vlorës në bregun e detit Jon. Në mënyrë të veçantë, në vitet e pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës, në këtë vend do të sendërtohej besimi i mrekullueshëm bektashian, përmes dervishëve dhe baballarëve që erdhën nga Qendra Botërore Bektashiane në Nevshehir të Turqisë, për ti begatuar këto gryka dhe shkropa me dashurinë e përjetshme ndaj Krijuesit. Fara e besimit tonë, ajo që në trevat shqiptare do të kishte shtat së pari në Sari Salltikun e Krujës së lashtë, po shpërndahej e rritej në mënyrë të shëndetshme pikërisht në Salarinë e bekuar. Në mënyrë të veçantë, në agim të shekullit të 20-të, kur roli dhe kontributi i teqesë së Turanit do të ishte përcaktues në lëvizjen kombëtare në Tepelenë, teqeja bektashiane në Qafën e Kreshtës, do të shërbente si një bastion i lirisë dhe i diturisë së besimtarëve të këtyre anëve. Dervishët dhe baballarët e saj, tashmë pothuaj të gjithë me origjinë shqiptare, me fjalën e urtë dhe propagandën e tyre, bënë çfarë ishte e mundur të zgjonin në vetëdijen tonë nacionale, veprimin energjik të betejave me pushkë, të ndërthurur me dëshirën e hershme për kulturën, historinë dhe identitetin nacional. Ka qenë kjo arsyeja që vetëm katër ditë pas djegies dhe shkatërrimit të teqesë historike të Turanit, i erdhi radha edhe faltores bektashiane në këtë vend ku ndodhemi sot. Andartët grekë nuk mund të linin këtë çerdhe lirie dhe diturie, të lulëzonte në zemër të Salarisë.



Në vitet që erdhën më pas, ndonëse teqeja u dogj nga themelet, besimtarët bektashianë e ruajtën brenda memories së tyre këtë objekt kulti, si një dëshmi e pakontestueshme e dashurisë së tyre ndaj doktrinës kulturore të Haxhi Bektash Veliut. Ky vend i mirë bektashian, kjo tyrbe e mrekullueshme këtu në gjoks të Salarisë, ka dy mrekulli. Njërenë e shohim. Ajo është mrekullia e gjeografisë së saj, është pamja që na afron si dhe lidhja fizike me Malin e Tomorit si edhe teqenë e famshme të Gllavës. Mrekullie tjetër është padyshim komunikimi shpirtëror i saj jo vetëm me salariatët, por edhe me besimtarët e ardhur nga Turani, Nivica, Gllava dhe deri nga

Lazarati. Sepse në fund të fundit, bektashizmi, është fryma që na bashkon të gjithëve, në udhëtimin tonë drejt udhës së Hakut, është fjala e dervishëve dhe baballarëve që sakrifkuan edhe jetët e tyre, për lirinë e besimit, të fjalës dhe të trojeve tanë arbërorë.”

...Pas ceremonisë zyrtare, këngët e bukura labe, zëri i mrekullueshëm i Golik Jaupit e grupit të Bënçës, grupi polifonik i Mallakastrës dhe këngëtarë të tjerë popullorë, me nefeset bektashiane e këngë të traditës, ja shtuan më shumë bukurinë kësaj dite të pelegrinazhit të shenjtë në Qafën e Kreshtës në Salari...

**Koesp.  
“Urtësia”**

# Mbresa nga pelegrinazhet në Gramsh

Nuri Çuni

Në ditën e pelegrinazhit në teqenë e Dushkut, së bashku me Olsi Karajin, Kamber Çelën stërnip i baba Kamberit, u nisëm nga qyteti Gramshit drejt malit gjarpërush me pyll pishe drejt teqesë me histori shekullore. Disa pelegrinë kishin ardhur herët dhe po bënë ritet bektashiane në dy tyrbet e kësaj teqeje. Me dashamirësi dhe ngrohtësi na priti Ali Targjini, kujdestari i teqesë, organizatori i përvitshëm i pelegrinazhit në këtë mjedis të mrekullueshëm mes pishash dhe lëndinat e bukura si të ishte pranverë, në këtë vap korriku. Së bashku me sekretarinë gjyshitës, Kamberin dhe shofer Rolandin bëjmë ritet, nderim qirinj dhe takohemi me disa nga pelegrinët e ardhur dhe urime me njeri-tjetrin për ditën e shënuar. Ali Taragjini me radhë na prezanton me disa intelektual të ardhur enkas për këtë ditë si: Fadil Gjuta, punon në Ministrinë së Bujqësisë-Tiranë, Haki Llapushi, Drejtor i shërbimit Pyjor-Gramsh, Fatos Coka, përfaqësues i Kishës Katolike-Elbasan dhe Dervish Dyrma,

Komandant i Trafikut të Policisë-Gramsh, Agron Ballolli, Xhevair Budani, Administrator i Njesisë Bashkiake Elbasan, në lagjen 5 maj, Vladimir Bajrami, Administrator Rajonal Bashkiake, Elbasan, Fatmir Votollari, Dritan Gashi, Elbasan, Ndriçim Sinani.

Ardhja e baba Faikut në këtë ditë u vlerësua nga të gjithë duke i uruar gëzuar dhe shëndet. Më pas u organizua një ceremoni modeste para teqesë, ku përshëndeti baba Faiku, duke u ndalur punën e madhe, përkushtimin e baballarve të kësaj teqeje, në vite, të cilët bënë edhe historinë e teqesë së Dushkut. Me kujdesin e veçant të Ali Targjinit u organizua një drekë për të ftuarit, këtë e sponsorizoi, Pëllumb Taragjini. Në urimet dhe këngët bektashiane kaloi dreka dhe sejcili solli, dashurinë dhe respektin për bektashizmin dhe rolin që po luan Kryegjyshata Botërore Bektashiane në Tiranë. Kjo ditë kishte edhe një veçori se ishte edhe 138 përvjetori i themelimit të teqesë së Dushkut, dhe 110 vjetori i kalimit nga jeta të baba Kamberit. Në hijen e pishave pelegrinët të organizuar sipas fiseve dhe shoqërisë kaluan këtë ditë të gëzuar. Kishte pelegrinë nga fshatrat përreth nga qyteti i Gramshit, Elbasanit dhe nga Skrapari dhe Korça. Sejcili duke u njohur me historinë dhe vazhdimësinë e bektashizmit, është meritë e këtyre shënjtorve që ne marim dritë. Të gjithë morën me vete uratat e shënjtorve të teqesë së Dushkut. U përcollën me dashuri për tu takuar në veprimtari të tjera për bektashizmin në Gramsh.

\*\*\*

Ditën e pelegrinazhit në Shëmbërdhenjë ishte në lëvizjet e besimtarëve dhe dashamirëve sa te tyrbja e madhe dhe te lisi i shenjtë baba Ali Horasanit, duke bërë ritet bektashiane. Në dhomën e pritjes dervish Xhelal Resuli, i cili me një buzëqeshje të ëmbël priste dhe përcillte pelegrinat e ardhur nga fshatrat e



Gramshit, Elbasani, Tirana, e Tomorrica e Skraparit, nga Korça, me dashurinë e kësaj ditë që përkujtohet përvit. Këtu vitin 1850 u themelua teqeja e bukur nga baba Mustafa Braçi po nga ky fshat, i dërguar me mision nga baba Abdullahi i teqesë së Melçanit. Vazhduan baballarët dhe dervishët në vite në këtë teqe me histori të madhe në rrethin e Gramshit dhe Tomorricës, si: baba Hyseni, baba Hasani, baba Meleqi, baba Bektashi, baba Halimi, dervish Temja, baba Veliu, baba Abedini, baba Zeqiri. Sigurisht hershmëria e saj lidhet me misionarin e parë baba Ali Horasani në shekullin e XVI. Mezalet në tyrbën e madhe dhe pranë lisit të shenjtë janë edhe shumë dervish që kanë shërbyer në vite në këtë teqe thotë dervish Resuli.

Ceremonia e thjeshtë para teqesë dha mesazhin e kësaj dite, në dashurinë e shënjtoreve të vendit dhe uratat e mirësit që marin gjithë pelegrinët në këtë ditë të veçantë fillim gushti, e hapi këtë dervish Xhelal Resuli. Më pas baba Halil Curri uroi të pranishmit për këtë ditë të shenjtë. Mirënjohje të gjithë klerikëve të kësaj teqeje që bënë historinë e saj e nuk harrohen kurrë. Ndërsa, në mesazhin e tij, baba Faiku, përshëndeti të pranishmit, se kjo teqe mban në memorjen e saj historinë shekullore dhe kujtojmë baba Meleqin e famshëm që shërbeu për 27 vjet, vjershëtor i madh, patriot e mësonjës kudo punoi për gjuhën shqipe. Nuk mund të harrohen vjershat e mrekullueshme të tij, për gjuhën tonë

\*\*\*

Ermenji një fshat piktoresk, ka afër teqenë e Shëmbërdhenjtit, duke udhëtuar në vapën e gushtit të duket si në pranverë me gjelbërimin e saj pa fund, përballë Tomorit të bënë me ndjesi të veçantë. Në hyrje të fshatit në lagjen Zaimaj të bie në sy mekami i baba Kubeja pranë shkollës dhe qëndrës Shëndetësor. Biseda interesante me plakun 92 vjeçar Muhamet Zaimi, në shoqërinë e Artur Zaimit dhe Olsi Karjit, sekretar gjyshatës Elbasanit, ai, tregon, se ky fshat ka tri mekame:

Mekami i baba Kubesë, ka një histori të hershme, siç tregojnë pleqtë e vjetër; ka ardhur qysh në shekullin e XVII, dhe është respektuar nga gjithë banorët e fshatit dhe zonës, ka qënë mekam i hapur pranë xhamisë. Ky mekam ka dhënë shenja dhe besimtarët kanë ndjerë, besim, shpresë edhe zgjidhje, prandaj respektohet nga të gjithë deri më sot. Edhe kur u prish në 1967 mekami, vinin fshehurazi dhe ndiznin qirinj. U rindërtua në vitet '90 nga familja jonë dhe shërbej me dashuri e respekt për këtë vend të shenjtë. Bisedën ai e vazhdon se, në



kurrizin e kodrës ndodhet mekami i derish Veli Plakut dhe dervish Veliu i ri (Pajaziti). Dervish Veli Plaku me kulturë të gjërë kish mbaruar mësimet fetare në Turqi



dhe u bë i njohur me dituritë dhe besimin bektashian, i cili rrezatonte në këtë zonë, ishte mirëbërës dhe zgjidhte problemet e hallet e besimtarëve. Po kështu



përgatiti edhe nipin e tij, që ia kish vënë emrin dervishi i ri, të cilin e çoi në Turqi e shkollti dhe e përgatiti der-

vish. Të dy dervishët mbanin vath, sipas kodit bektashian. Dervishi i ri vazhdoi rrugën e dervish Plakut, ai si të thoshte bënte, ndërroi jetë në vitin 1962.

Plaku Muhamet Zaimi vazhdoi të tregonte, se midis dy mekave është edhe mekami "Zenea", i cili ka qënë herët vendi i shenjtë, i hapur, ndërtesë e vjetër me mur guri. Thuhet se kur donin të bënin shtëpi në këtë vend nuk mbante muri, ka ndodhur ngjarje të hidhura.

\*\*\*

Sipas kalendarit bektashian të vitit 2018 u organizua pelegrinazhi te Vendi i Mirë, Vakëf në fshatin Tunjë të Gramshit. Me dervish Sali Peti duke u ngjitur në kthesë e fshatit Llaha drejt kalasë arrijmë në Tunjë. Është viti i dytë që organizohet pelegrinazhi, në këtë fshat, ka mundur të afrojnë besimtar dhe dashamirës nga fshati dhe zona përreth Gramshit. Një pelegrinazh modest, që me mundësit e saj kujdestarja Alketa Llaha, që punon për disa vite me radhë ajo ka mundur të afrojnë besimtar dhe dashamirës nga fshati dhe zona përreth Gramshit. Gjithashtu edhe ndërtimin e saj e ka përballuar vet me të afërmit e saj. Historia e këtij vendi sipas pleqve të vjetër si: Qemal, Gani, Tahir LLaha, në këtë vend që quhet Vrom ka qënë një varrezë e madhe

dhe posht saj ishte një xhami dhe Vakëf. Deri vonë kanë qënë 6-7 gurë varresh me simbole bektashian, taxhi i ndarë në katër pjesë, që tregojnë për katër porta (shariat, tarikat, hakikat, marifet) dhe teslimin. Njërin syresh është vendosur në hyrje të tyrbes, e cila është gjetur këtë vit në ferrë në dherat e hedhur nga punimet me traktor mbas vitit 1990. Pelegrinazhi ishte i thjeshtë, erdhën nga fshati dhe qyteti i Gramshit, nga Durrësi, sidomos të rinj dhe të reja, rreth 70 veta. Pasi u bënë ritet në tyrben, bëmë edhe një vizitë së bashku me dervish Sali Petin, në familjen e Qemal Llaha, të kujdestares Alketa që është vajza e tij, i cili na priti me ngrohtësi dhe dashuri.

Përsëritet gjithashtu në emër të fisit Llaha Tahiri, Në këtë pelegrinazh u kënduan këngë bektashianë për baba Selman Martaneshi, Dede Reshatin, e këngë popullore. Në drekën e shtruar enkas nga kujdestarja Alketa, u pëlqyen nga të gjithë, këngët e kënduara prej dervish Sali Petit. U ndanë nga ky pelegrinazh me respekt të veçantë, me dashuri dhe mirënjohje për Kryegjyshatën Botërore Bektashianë.

\*\*\*

Në mëngjes herët nisemi për në pelegrinazhin e tyrbes së baba Hajdarit në Komjan. Arrijmë në orën 10, dhe bëjmë ritualin bektashian,

aty takojmë tyrbetaren znj. Dituri Ajazi, 70 vjeç. Flet pak dhe përsërit se ky është shënjtor e kemi ringrituar si fis mbas '90-ës në këtë vend. Sipas Ali Targjinit ka histori interesante, Baba Hajdari është me origjinë nga Opari i Korçës shërbente si punëtor në teqen e Dushkut, ishte i zgjuar dhe mësoi shumë mirë rregullat bektashianë, u vesh dervish nga baba Rexhepi punoi mjaft kohë në këtë teqe. Para se të kalonte nga kjo jetë e la me gojë që të më varrosni në malin e Komjanit përballë Tomorrit. Në vitin 1935 u ngrit tyrbja në Komjan nën kujdesin e baba Rexhepit, familja Ajazi i ka shërbyer këtij vendi gjatë gjithë kohës. Këtu vit pas viti organizohej Sulltan Novruzi, matemi dhe u bë traditë që në fund të gushtit bëhesh pelegrinazh për këtë shënjtor dhe vazhdoi deri në vitin 1967, ku shkatërrua nga themelet nga sistemi monist me ligjin famkeq kundër fesë. U ringrit sërish nga familja Ajazi në vitet 90. Ka patur edhe problem në këtë familje me ngjarje tragjike. Mbas viteve 1935. Pelegrinët e ardhur nga gjithë fshatrat e Gramshit, Opari, Tomorrice dhe Korça, nga Durrësi, Lushnja dhe Tirana i dhanë gjallëri këtij pelegrinazhi tradicional të përvitshëm. Erdhi edhe baba Faiku, ai, me takime dhe biseda, afroi veç dashuri, besimtarët dhe dashamirësit e takonin me respekt dhe nuk iu ndan deri në fund. U shpërndanë revista "Urtësia". Gjithë veprimtaria u fokusua me aparat fotografik. U organizua edhe një drekë me këngë bektashianë dhe u dha edhe mesazhi i Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Natyra e bukur përballë Tomorrit të jepte një ndijesi të veçantë, pelegrinët morën dashurin e vendit të shenjtë dhe shpresën, dashuri për Zotin.



# Identiteti fetar si vlerë

**Kongresmeni Dioguardi: Jemi në krahun tuaj, në të mirë të bektashizmit por edhe të frymës që ju përcillni në Ballkan, duke ndërtuar ura paqeje dhe dialog vëllazëror.**

**P**ara disa ditësh, Selia e Shenjtë e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, në bashkëpunim të ngushtë me stafin udhëheqës të Gjyshit Bektashiane Tetovë, organizuan në New York, një sesion dëgjimor rreth problemeve të sotme të teqesë "Harabati Baba" në Maqedoninë Veriore. Përveç Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, merrte pjesë dhe sekretari për marrëdhënie me jashtë z. Arben Sulejmani. Ndërsa të ftuarit, ishin pjesë e botës akademike, personalitete të lartë fetarë dhe shtetërorë të New-Yorkut. Takimi i zhvillua në Selinë e "Vatres" në Neë-York, nën kujdesin e plotë të z. Agim Rexhaj.

Ishte pikërisht z. Rexhaj i cili çeli seancën dëgjimore duke u ndalur në situatën aktuale në Ballkan e Shqipëri, foli për rrjedhat zhvillimore të cilat po u afrohen ditaditës dyerve të Europës, përmes vullneteve politikë dhe objektivave ekonomikë. Ai vlerësoi gjithashtu kul;turën dhe dialogun fetar në territoret shqiptare në Ballkan duke u ndalur veçanërisht në rolin e pazëvendësueshëm të Selisë së Shenjtë Bektashiane me qendër në Tiranë. Ky rol, u shpreh ai, në momentet kyçe të historisë së kombit tonë, ka rrëfyer se besimi në Zot është i vërtetë dhe i gjithëfuqishëm, në çdo rast që lidhet me fatet e

vatanit.

Paskëtaj, ishte Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili i bëri një ekspozitë të qartë lindjes dhe zhvillimit të tarikatit



bektashian në Ballkan nga shekulli i 14-të dhe deri sot, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në rrethanat historiko-gjeografike që mundësuan përhapjen e këtij besimi. Në mënyrë më konkrete, ai vuri në dukje dinamizmin dhe atdhetarizmin që ky tarikat përcolli në lëvizjen autonomiste shqiptare, me ç'rast doktrina shpirtërore u printe zhvillimeve kombëtare. Në fund të fjalës së tij, Kryegjyshi Botëror u shpreh: "Kur flasim për identitetin tonë fetar ne

kemi parasysh se tarikatet kanë qenë dhe mbeten pasuri e pazëvendësueshme e Islamit tonë, e Islamit shqiptar që na e përcollën të parët tanë. Është detyra jonë që këtë frymë ta përcjellim sa më të pastër tek brezat e sotëm dhe të nesërm dhe për këtë vlen midis të tjerave të ndërthurim në mënyrë sa më harmonike traditën e ardhur ndër shekuj me kontekstet e sotëm fetarë dhe moralë. Teqaja 'Harabati Baba' në Tetovë ka një histori 500 vjeçare dhe e rëndësishme është të kujtojmë sot se ajo i kapërceu kufijtë e thjeshtë të një shtëpie për besimtarët, por u shndërrua në një vatrë të dijes, të gjuhës

shqipe, të mendimit dhe të veprimit kombëtar, duke lënë gjurmë të padiskutueshme në historiografinë ballkanike dhe atë shqiptare. Edhe gjatë këtyre 25 viteve të fundit, me veprimtarinë e vet fetare, kjo teqe ka shërbyer si një oaz paqeje dhe shprese. Pikërisht për këtë arsye, ne kemi qenë shumë të kujdesshëm në çdo veprim tonin, kundër atyre që na uzurpuan pa të drejtë mjedise brenda kësaj teqeje historike. Në asnjë rast ne nuk kemi hezitur të thërrasim dialog dhe bisedime me çdokënd, por përgjigjet nga ana tjetër, mbeten lehtësisht të kuptueshme se nxisin mërinë dhe urrejtjen brenda familjes sonë fetare. Rasti i gjykimit në Strasburg, është dëshmia më e madhe e realizimit të të drejtave tona.”

Ndërsa z. Arben Sulejmani i njohu të pranishmit me krejt dinamikën e zhvillimeve juridike të teqesë “Arabati Baba” nga viti 1992 deri më sot. Ai u ndal në dokumentacionin e plotë që Gjyshata e Tetovës disponon rreth këtij problemi si dhe takimet e marrëdhëniet me ambasadat e huaja në Shkup, me të cilat janë ndarë situata shumë të vështira, të nxitura nga ekstremistë të dhunshëm fanatikë, të cilët jo rrallë kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë përkrahjen e mekanizmave të ndryshëm shtetërorë.

Më tej, Kryegjyshi Botëror u takua me kongresmenë, autoritete të lartë fetare të feve të ndryshme. Tepër domethënës ishte takimi me z. Josep Dioguardi, i cili është i njohur tanimë në botën shqiptare si përkrahës i palëkundur i çështjeve tona kombëtare. Pasi dëgjoji me kujdes Kryegjyshin Botëror, z. Dioguardi u shpreh mes të tjerave se jemi në krahun tuaj, në të mirë të bektashizmit por edhe të frymës që ju përcillni në Ballkan, duke ndërtuar ura paqeje dhe dialog vëllazëror.

## Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj merr pjesë në Kongresin e Pestë Botëror të Studimeve mbi Lindjene Mesme dhe Afrikën Veriore, nga 18-20 korrik në Sevilje-Spanjë.



**N**ën patronazhin e Madhërisë së Tij, Mbretit të Spanjës dhe Mbretit të Marokut u mbajt në Sevilje të Spanjës në datat 18-22 korrik 2018, Kongresi i Pestë Botëror i Studimeve mbi Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore, në të cilën mori pjesë dhe një delegacion i Selisë së Shenjtë Bektashiane, i kryesuar nga Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Ky kongres i cili mbahet një herë në katër vjet, konsiderohet si një nga më të rëndësishmit në botë mbi problemet dhe prioritetet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën veriore, në përpjekje për transferime sociale dhe ekonomike. Në Sevilje ishin gati 200 pjesëmarrës dhe kumtues nga 76 vende të botës.

Qysh në krye të herës duhet thënë se delegacioni i Selisë së Shenjtë Bektashiane, u përshëndet nxehtësisht nga Drejtori i Fondacionit Tri Kulturat e Mesdheut, z. Joze Manuel Cervera, i cili njohu të





# Për një botë më të mirë



pranishmit me veprimtarinë e Selisë së Shenjtë Bektashiane në funksion të dialogut ndër fetar, jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë. Më tej, ai theksoi se dita fetaro-kulturore Bektashiane, vlen të merret si shembull në përbushjen e detyrimeve shoqërore që institucionet e sotme fetare u japin në mënyrë të veçantë brezave të rinj.

Në mënyrë të veçantë bektashinjtë tërhoqën vëmendjen e kongresmenëve, në panelin rreth kulturave që fetë përcjellin tek ndjekësit e tyre. Shembulli i teqeve të sotme erdhi në mediumet e Seviljes, jo vetëm si përpjekje për

të ecur në gjurmët e traditave, por edhe si luftë e papajtueshme ndaj çdo lloj fanatizmi apo devijimi nga dliresitë me të cilat na ushqen mëshira universale myslimane. Në një prej bisedave të tilla, Kryegjyshi Botëror Bektashian u shpreh mes të tjerave se përpjekjet e Selisë së Shenjtë Bektashiane kanë qenë sidomos në perceptimin e dashurisë ndaj Krijuesit. Të gjitha ritet apo sjelljet në vendet tona të shenjta, ne nuk i shohim si qëllim znë vetvete-u shpreh ai-por si një bagazh shpirtëror që do të na ndihmojë në marrëdhëniet midis njeri-tjetrit, në familje, në shoqërinë e sotme, e cila rrezikon të 'marrë plagë' prej rrjedhave të globalizmit. Sidoqoftë, ne gjykojmë se duhet të jemi së bashku jo vetëm në Kongrese apo Simpoziume Ndërkombëtare, por në mënyrë të veçantë në qerthullin e përpjekjeve për një botë më të mirë, pa terrorizëm, pa rreziqe fetarë, pa dallime esenciale dhe veprime të dëmshme në kurriz të sho-shoqit. Vetëm së bashku mund të ecim në misionin tonë.

Gjatë ditëve të aktivitetit në fjalë, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj u takua dhe zhvilloi biseda frutdhënëse me Prof. Emilio Gonzales, Drejtor i studimeve islame në Universitetin e Seviljes, znj.

Elena Argita Maza, profesore në departamentin e studimeve islame në Universitetin e Grenadës etj.

Përgjithësisht, lider fetarë dhe studiues ishin të interesuar për rrjedhat e tarikatit bektashian në tetë shekujt e ekzistencës së tij, si dhe sfidat me të cilat përballet sot Selia e Shenjtë Bektashiane në Tiranë.

**Koresp. "Urtësia"**



# Së bashku në sfidat e lirisë

**Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj merr pjesë në Ministerialin e Lirive Fetare të organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit në Washington D.C**



Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, në seancën e diskutimeve për persekutimin e lirive fetare, në të cilën përveç liderëve të lartë fetarë, merrnin pjesë edhe zyrtarë përkatës përgjegjës në DASH. Në krye të herës, Kryegjyshi Botëror bëri një ekspozitë të shkurtër të përgjegjësisë historike me të cilën përballet Selia e Shenjtë Bektashiane në Tiranë, e cila në vijueshmëri të plotë dhe koherente me traditat më të vjetra të bektashizmit, përpiket dita-ditës të ushqejë milionat e besimtarëve të sajë të kudondodhur në botë, jo vetëm me besimin e palëkundur në Zot por edhe me tiparet shpirtërore më të spikatur të lirisë dhe harmonisë fetare. Vetë kushtet historike të lindjes dhe zhvillimit të tarikatisë bektashi, i cili u frymëzua prej vlerave të Islamit dhe urtësisë së Haxhi Bektash Veliut ishin të tilla, vijoi Kryegjyshi, që na mësuam të ndajmë së bashku me besimtarë të tjerë jo vetëm qiellin dhe tokën që na ka falur Zoti i Lartë, por edhe idetë, zakonet, sjelljet dhe qëndrimet midis fqinjëve, të kodifikuara kurdoherë përmes tolerancës sonë proverbiale.

**M**e ftesë të Departamentit të Shtetit, Kryegjyshi Botëror Bektashian, mori pjesë në Ministerialin e Lirive Fetare, në të cilin u diskutua rreth problemeve më të tilla si sfidat e sotme fetare, lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm, masat e mundshme preventive ndaj gjenocideve të dhunshëm si dhe persekutimit fetar, gjithashtu të drejtat njerëzore të para në këndvështrimin e lirive religjionare. Përvoja me histori e fe të ndryshme, u sollën përmes shembujve konkretë, me idenë e zvogëlimit e parandalimit të konflikteve, ku lider fetarë nga shumë vende të botës, parashtruan përvojat dhe shqetësimet e tyre.

Me interes të jashtëzakonshëm u përcoll tek të pranishmit, fjala e Kryegjyshit Botëror Bektashian,

Më tej, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në parimet që bien ndesh me liritë fetare, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u shpreh midis të tjerave: "Unë dua të sjellë në vëmendjen e këtij auditori kaq shumë të nderuar se mesazhet me të cilët kemi përcjellë situata tejet shpërthyes në Ballkanin tonë të trazuar nga histori dhe mite gjithfarësh, kanë në të gjitha rastet, paqen universale myslimane. Kultura jonë shpirtërore

dhe veprimi ynë i matur, kurdoherë brenda konteksteve fetarë, moral dhe ligjorë, ka bërë të mundur që të fitojmë të drejtat tona këto kohët e fundit, në lidhje me pronësinë ndaj teqesë "Harabati Baba" të Tetovës. Ndonëse u ndeshëm me indiferencën e mekanizmave shtetërorë të Maqedonisë Veriore si dhe të Bashkësisë Islame aty, ne kërkuam për rikthimin e të drejtave deri në Gjykatën Europiane të Strasburgut, e cila dha verdiktin e saj të bazuar në dokumente të ligjshëm. Ndonëse për vite me radhë, bile edhe tani që po flas, ne kërcënohemi në shtëpinë tonë, në shtëpinë e Zotit prej ekstremistëve fetarë, ju siguroj miq të nderuar se përpjekjet tona do të jenë vetëm rrugët paqësore, fryma vëllazërore me të cilën u edukuam dhe këndvështrimi i situatave përmes dialogut dhe mirëkuptimit.

Fatkeqësisht, përfundoi fjalën e Tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, midis miqve tanë që na inkurajojnë dhe na ndihmojnë në misionin e lartë dhe fisnik të Selisë së Shenjtë Bektashiane ka edhe dy-tri ambasada të huaja në Tiranë, të cilat duan ta zbehin këtë rol përmes qëndrimeve joparimorë dhe në kundërshtim me vëllazërinë që ushqen Islami i shëndetshëm. Mosrespektimi i besimtarëve bektashianë në vendet që këta përfaqësojnë, përpjekjet për të mbajtur teqetë të mbyllura apo si objekte muzeale, ndërhyrjet e qëllimshme ndaj strukturave të hierarkisë sonë shekul-

lore, kanë bërë që Selia e Shenjtë Bektashiane dhe unë personalisht, të ngremë zërin lart, duke i cilësuar këto qëndrime si të paprecedent në moralin fetar mysliman. Ndërkaq ne i kemi kërkuar dhe i kërkojmë shtetit shqiptar të ketë vëmendje të veçantë për të njohur atributet e Selisë së Shenjtë Bektashiane me qëndrim dhe status të veçantë juridik".

Pas mbylljes së ministerialit, Kryegjyshi Botëror Bektashian u takua dhe zhvilloi biseda të këndshme me Ndihmës Sekretarin e Shtetit John Sullivan dhe Ambasadorin z. Large Sam Bronwnback, të cilët ishin tepër të interesuar për rolin e bektashizmit në Shqipëri, Ballkan e më gjerë, si edhe me Drejtorin Ekzekutiv të Fondacionit për Vlera Humane, Filiz Odabas'Geldiay, me Presidentin e Organizatës për Aksion Humanitar z. Thet Mon Phyo, me Presidentin e Fondacionit Falun z. Jeff Chen, me producentin e njohur të 'Zërit të Amerikës' z. Joan Deluca, me politikanë dhe studiues të tjerë. Ai iu përgjigj interesit të miqve të DASH në lidhje me zhvillimet e sotme botërore bektashiane si dhe sfidat e nesërme, duke i siguruar ata jo vetëm për 'shtrirje' në hapësira të reja fizike dhe shpirtërore, por edhe mospranim të ndërhyrjeve nga të tjerë, duke pasuruar bektashizmin me vlera të reja.

**Koresp. "Urtësia"**



# Me frymë solidariteti

**Kryegjyshi Botëror Bektashian u shpreh midis të tjerave: “Ndihem krenar që jam bashkëkombas i kësaj shenjëtores vepra e së cilës do të rrezatojë gjatë në të gjithë globin.”**



I ftuar nga Urdhëri Ndërkombëtar i Personaliteteve dhe Filantropistëve për Europën, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë në takim të radhës në Kalkutë-Indi në datat 29-31 korrik 2018. Ai u prit personalisht nga princesha Maria Leonora Torres, e cila ka vlerësuar lart këto kohë, rolin e Selisë së Shenjtë Bektashiane në dialogun ndërfaqësor. Në njërin prej paneleve, e mori fjalën Kryegjyshi Botëror, i cili foli për rolin e fesë në sfidat globale. Midis të tjerave ai u shpreh: “ Bismillah Rrahmani Rrahim! Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirbërësit! Të nderuar organizatorë të këtij

eventi në shërbim të paqes universale, përmes rolit të fesë, më lejoni t’ju sjell urimet më të mira e miliona besimtarëve bektashinj që unë përfaqësoj. Me gjithë shpirt, në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, ju përcjell juve dhe krejt familjeve tuaja, urimet më të sinqerta dhe bekimet më të ndjera! Si një lider i tariatit bektashi, i cili në 800 vitet e ekzistencës të vet, po fiton dita-ditës terene të rinj shpirtërorë përmes mesazheve që përcjell, unë do të kisha dëshirë të flisja gjatë për rolin në fetë, në kuptimin e shpresave që ajo gjeneron për një jetë më të mirë. Por në mungesë të kohës dhe i prir që në disa minuta të jap gjykimin tim modest në këtë rrafsh. Mendoj se duhet marrë

në konsideratë fakti që feja dhe globalizmi nuk duhen marrë si konstante që përjashtojnë njëri-tjetrin. Në këndvështrimin historik dhe shpirtëror është e pamundur t'i konceptosh fenë dhe globalizmin si një duet në luftë të "përjetshme", përkundrazi një afrim rigorozisht paqësor në dinamikat e tyre, të bën të mendosh për një ndërveprim unik që i karakterizon.

Rritja simetrike e niveleve ekonomike, krenaria naive e mirëqenies individuale dhe asaj familjare, barrikatat e përditshme që nefsi apo egoja jonë ngrenë ndaj jetës së vërtetë, e asaj shpirtërore, gjithë këto "mirësi" që na ofron globalizmi bashkëkohor, ne kemi mundësi të paimagjinueshme për t'i kapërcyer përmes përfshirjes sociale, frymës së thellë të solidaritetit njerëzor dhe dialogut fetarë. Më mirë se deri më sot, ne vlen të shmangim traumat raciste dhe persekutimet gjoja në emër të etnive fetarë. Nuk kam as dyshimin më të vogël se feja me filozofinë, mendimin dhe qëndrimin unik të saj, ka qenë dhe mbetet një barrier e fuqishme ndaj çdo shfaqjeje të globalizmit për t'a shndërruar mjedisin e sotëm botëror, në një plasdarmë luftrash për dollar. Kjo edhe për faktin që vetë Krijuesi i ynë i përbashkët, me gjenialitetin e pashembullt mundi të krijojë këtë univers deri në atomin e fundit. Por sigurisht ne vlen të bashkohemi të gjithë në këtë kauz, duke edukuar brezat e rinj me vizionet e shkëlqyer fetarë në këtë kontekst, jo thjesht për ardhmërinë dhe sigurinë fizike të tyre, por sidomos për t'u integruar në cilësitë më të vyera

të jetës shpirtërore. Sa i përket barazisë gjinore, dua të them se edhe sipas Kuranit të Madhëruar, dashuria për këtë botë dhe për këtë jetë është e pranishme qysh në zanafillë të njeriut. Madje sipas mistikëve të shekujve të parë të Islamit, kjo botë është një galeri artesh ku shfaqen emrat e Allahut. Në çdo dukuri që realizohet në këtë botë reflektohen si thyerje të mrekullueshme drite emrat e Tij. Çdo qenie njerëzore më vete, grua apo burrë qoftë, është një frymë e dalë prej gjoksit të Allahut, të denjë për të dashuruar dhe për t'u dashuruar. Fetë dhe besimet me mijra, ato të shekujve të shkuar dhe të sotmet, mund të gjejnë një gjuhë më komunikuese midis tyre, në kërkim të barazisë gjinore.

Të nderuar të pranishëm! Falë globalizmit dhe manierave të tij, bota sot sa vjen dhe bëhet më e vogël. Ne liderët fetarë, fetë dhe besimet, kombet dhe etnitë, kemi ardhur në këtë botë si vullnet i Zotit. Dhe për derisa neve kemi ardhur në këtë botë me vullnet të Tij, le të jetojmë së bashku në qiell dhe në tokë që na ka falur".

Mbresëlënëse ishte gjithashtu vizita e të pranishmëve nga shumë vende të botës në mauzoleon ku prehet në paqe shenjëtoria Nënë Terezë. Duke e marrë fjalën këtu, Kryegjyshi Botëror Bektashian u shpreh midis të tjerave: "Ndihem krenar që jam bashkëkombas i kësaj shenjëtoreje vepra e së cilës do të rrezatojë gjatë në të gjithë globin."

Kryegjyshi zhvilloi takime të rëndësishme me shumë prej pjesëmarrësve atje.



# WITH A HIGH SPIRIT

Invited by the Global Order of the Dignitaries, the World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, participated in its Meeting in Calcuta - India, on July 29-31 2018.



ter life which it generates. But, because of lack of time, I am disposed to present my humble opinion in few minutes. I think that we have to take into consideration the fact that the religion and the globalism are not two constants which exempt each other. By the historical and spiritual point of view, it is impossible to conceive the religion and the globalism in eternal war between

**T**he World Grandfather was received by the Princess Maria Leonora Torres, who highly appreciated the role of the Bektashi Holy See in the interreligious dialogue. In one of the panels of the Meeting, the World Bektashi Grandfather delivered his speech, in which, among others, he said:

Bismillah Al-Rahmani Al-Raheem!  
In the name of God, the all Merciful, the all Compassionate!

Honored organizers of this event serving to the universal peace,

through the role of the religion, let me bring you the best wishes of millions of Bektashi believers, that I represent! In the quality of the World Bektashi Grandfather, I bring you and to your families, with all my soul, the most sincere wishes and blessings!

As a leader of the Bektashi tarikat, which, after 800 years of its existence, is gaining spiritual ground day in day, through the messages it transmits, I would like to speak long about the role of the religion, in the sense of the hope to a bet-

them; on the contrary, a pacific approach between them could make us think about a unique interaction, which characterizes them. Through the participation to the social life, the spirit of human solidarity and the religious dialogue, we have unimaginable possibilities to overcome the symmetrical growth of economical levels, the naive pride of the individual and familiar well-being, the everyday barricades that the greediness and our egoism put against the real life and other "good things"

# IT OF SOLIDARITY



offered by the contemporary globalism. Better than till now, we have to avoid the racial discriminations and the persecutions allegedly “in the name of the religious entities”.

I have no doubt that the religion, with its philosophy, its thought and its unique attitude, has been and remains a powerful barrier towards every form of globalism aiming the transformation of the actual world environment in a place d'armes of war for money. Our common Creator, with the unexampled geniality, created this Universe, until the last atom. Surely, we have to be united for this cause, educating the new generations with the brilliant religious visions, in this context, not only for their future and for their physical security, but especially for their education with the most precious qualities of the spiritual life.

Regarding the gender equality, I would like to say that even according to the Sublime Koran, the love

for this World and for this life, has been always present, since the origin of the Mankind. According to the mystics of the first century of Islam, this World is an art's gallery, where appear the names of Allah. In every phenomenon of this World are reflected His names, as brightening lights. Every human being, man or woman, is a breath from the chest of Allah, worthy to love and to be loved. Thousands of religions and faiths, those of the centuries of the past and the actual ones, may find a more communicative language between them, looking for the gender equality.

Honored presents!

Because of the capitalism and its manners, the World is becoming smaller. We, religious leaders, the religions and faiths, the nations and the peoples, came in this World as the will of God. And, as long as we came in this World because of the will of God, let us live together, in the heaven and in the earth He gave us.

# URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË

KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.127 GUSHT 2018

